



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1774/4 Prot.

Vlorë më, 15.11.2022

VENDIM

Nr. 48, datë 14.11.2022

PËR
MIRATIMIN E TARIFËS SË SHKOLLIMIT PËR PROGRAMIN E CIKLIT TË
DYTË TË STUDIMEVE MASTER PROFESIONAL NË MËSUESI PËR ARSIMIN
FILLOR KL. I-V

Në mbështetje të nenit 3, pika 3, gërma ç, nenit 38, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 25, pika 1 gërma i, Udhëzimit nr.1, datë 14.04.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, si dhe referuar propozimit të Administratorit ardhur me shkresën nr. 1728 prot, datë 11.11.2022, Senati Akademik në mbledhjen e datës 14.11.2022,

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifën për programin e ciklit të dytë të studimeve Master Profesional në Mësuesi për Arsimin fillor Kl. I-V si më poshtë:

Emërtimi I programit	Kreditet e programeve te ciklit te dytë te studimeve	Tarifa per kredite ne nje program te pare ciklit te dytë te studimeve	Tarifa per nje program te pare te ciklit te dytë te studimeve	Tarifa per kredite ne nje program te pare ciklit te pare te studimeve	Tarifa per nje program te dytë te ciklit te dytë te studimeve
Program master Profesional "Master profesional në mësuesi për arsimin fillor kl. I-V "	120	1000	120,000	1200	144,000

2. Ngarkohet për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi Departamenti i Edukimit, Zv.Rektori Akademik si dhe Drejtoria e Edukimit të Ciklit të parë dhe të dytë të studimit.
3. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratim të mëtejshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. ROLAND ZISI

